

## Atraksionet turistike në Komunën e Lipjanit

Nr.	Emertimi	Përshkrimi i atraksionit	Kategoria	Adresa	Komuna
1	Shpella e Gadimës	Ndodhet në fshatin Gadime e Ulët e Komunës së Lipjanit, 3 km larg rrugës magjistrale Prishtinë- Ferizaj- Shkup. Shpella me kanalet e saj është e lokalizuar në sukën e “Mërturit”, ndërsa hyrja ndodhet në pjesën e poshtme të grykës së lumit Klytura në lartësi mbidetare 580 m. Pas zbulimit shpella është marrë nën mbrojtje ligjore – 1969, me sipërfaqe të përgjithshme prej 38.6 ha. Për shkak të vlerave të mëdha, stolive, dukurive shpellore interesante dhe pozitës së përshtatshme shpella hapet për vizitor në vitin 1976.	Atraksion natyror	Gadime	Lipjan
2	Janjeva	Janjeva ishte një vendbanim i vjetër që nga viti 1303. Me zhvillimin e industrisë së minierave, shek.XIV dhe XV është bërë qendër e rëndësishme mes Prishtinës dhe Artanës. Në mes të tjerave qyteti ka patur kontakte me Republikën e Raguzës (Dubrovnikut). Një prej shkollave të para në Kosovë është hapur në Janjevë në 1665 e cila edhe sot është në funksion.	Atraksion natyror	Janjevë	Lipjan

3	Blinaja	<p>Parku Kombëtar i Blinajës gjendet në komunën e Lipjanit afër fshatit Magurë, rreth 32 km nga Prishtina dhe me një lartësi prej 600-850 m mbi nivelin e detit.</p> <p>Ky atraksion shtrihet në një sipërfaqe prej rreth 3 mijë hektarësh të rrethuar.</p> <p>Sipas destinimit, është zonë gjuetie me rëndësi të veçantë, e themeluar në vitin 1955 me sipërfaqe të përgjithshme prej 2.794 ha.</p> <p>Bota e gjallë bimore e kësaj bukurie natyrore përfaqësohet nga një numër i madh llojesh autoktone, si dhe nga fauna e egër, ku mund të ndesheni me drerin, derrin e egër, macen e egër, dhelprën, etj., ndërsa pos kafshëve, parku është i pasuruar edhe me disa lloje të shpezëve, që kanë gjetur strehë në këtë mrekulli.</p> <p>Në brendi të Parkut Blinaja gjenden edhe 30 liqene artificiale si dhe janë të ndërtuara 30 penda ujëmbledhëse me qëllim të furnizimit me ujë gjatë gjithë kohës, dhe të gjitha këto e bëjnë këtë park nga vendet më tërheqëse në Kosovë për t'u vizituar.</p>	Atraksion natyror	Blinajë	Lipjan
---	---------	--	-------------------	---------	--------